

VIZE PER MISION

Viza për Mision i lejon hyrjen në Itali atij personi që punon për Administratën Publike vendore, për Ente Publike ose për të tjera Organizata Ndërkombëtare dhe që udhëton për arsye të lidhura me funksionin e tij politik, qeveritar ose publik.

Çdo banor i Kosovës i cili kërkon vizë hyrjeje në Itali për Mision mund të paraqitet personalisht (ose të ngarkojë një person zyrtar të besuar) pranë Sportelit të vizave të Ambasadës Italiane në Prishtinë në ditën e në orën e caktuar dhe t'i dorëzojë personelit përkatës "Formularin e kërkesës për vizë" me dy fotografi aktuale sipas standardit ICAO, të mbushur në të gjitha pjesët e tij me gërma të mëdha shtypi. Kërkesës për vizë duhet t'i bashkangjiten dokumentet e poshtëshënuar si edhe një fotokopje e qartë e tyre:

1) Pasaportë të vlefshme të paktën deri në skadimin e afatit të vizës së kërkuar;

2) Kërkesë zyrtare nga organizma qeveritarë italian ose organizata ndërkombëtare me seli në Itali në të cilën të kërkohet lëshimi i vizës hyrëse për personin e ftuar si edhe të deklarohen qartë dhe shprehimisht;

- qëllimi i vizitës së personit të ftuar;
- data e fillimit dhe kohëzgjatja e tij;
- mbulimi i shpenzimeve financiare;
- adresa e vendqëndrimit gjatë vizitës në Itali.

3) Dokumente që vërtetojnë pozitën dhe qëllimin zyrtar të udhëtimit: Notë Verbale e lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Kosovës, (nëse personi i ftuar është zyrtar pranë Presidencës, Kuvendit ose Qeverisë së Republikës së Kosovës) ose Vërtetim i lëshuar nga drejtori ekzekutiv (nëse personi i ftuar është zyrtar i të tjerë organizmave qeveritarë ose i organizatave ndërkombëtare);

4) Dokumente që vërtetojnë mbulimin e shpenzimeve financiare (nëse nuk mbulohen nga Enti ftues); Vërtetim me shkrim i zyrtarëve të lartpërmendur mbi mbulimin e shpenzimeve financiare të nevojshme për qëndrimin në Itali;

5) Dokumente që vërtetojnë mjetet e transportit: bileta ose rezervimi (Vajtje/Ardhje) ose fotokopje e dokumenteve të automjetit (nëse udhëtohet me makinë);

6) Sigurim shëndetësor ndërkombëtar i njohur nga Ambasada Italiane në Prishtinë; polica e sigurimit shëndetësor duhet të jetë e nënshkruar pranë njëres prej Kompanive vijuese të Sigurimit: **ADAC-VERSICHERUNGEN, ELSIG, ILLYRIA, KOSOVA E RE, SIGAL, SIGKOS, SIGMA e SIGURIA**; ajo duhet të jetë e vlefshme në të gjithë hapësirën territoriale të shteteve Schengen, duhet të mbulojë shpenzimet spitalore në rast sëmundjeje dhe/ose aksidenti si edhe shpenzimet e nevojshme për riadhesimin e kufomës në rast vdekjeje. Shuma siguroese minimale nuk duhet të jetë më e vogël se 30.000 Euro

Kujdes: Renditja e Kompanive të Sigurimit të sipërshënuara është bërë në rend alfabetik dhe nuk shpreh, në asnjë mënyrë, asnjë preferencë zgjedhjeje nga ana e Sektorit të Vizave pranë kësaj Ambasade.